



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË RANILLUGUT PËR VITIN 2022

Prishtinë, maj 2023

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Ranillugut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Ranillugut (KR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Ranillugut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Ranillugut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

B1 Mos verifikim i pronave për qëllime të tatimit në pronë.

B2 Mos regjistrimi i pasurisë nën 1000€ përmes sistemit e-pasuria

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Ranillugut.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Ranillugut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Ranillugut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Ranillugut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Ranillugut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Krahasuar me vitin paraprak, Komuna ka pasur përmirësime në raportimin financiar dhe ka ndërmarrë masa korigjuese të cilat kanë qenë objekt i opinionit në raportin e auditimit për vitin 2021. Megjithatë, ka ende çështje të përsëritura që kërkojnë përmirësim në disa fusha të sistemit të kontrollit të brendshëm. Fushat për përmirësime të mundshme janë: dobësitë në mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë që kanë të bëjnë me mos verifikimin e pronave, mos regjistrimi i pasurisë nën 1000€ (përmes softuerit e-pasuria), angazhimi i pamjaftueshëm për mbledhjen e të arkëtueshmeve dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm jo funksionale në komunë të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtim në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ky raport ka rezultuar me katër (4) rekomandime, nga të cilat (3) tri rekomandime janë përsëritur, ndërsa një është përsëritur pjesërisht.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B1 - Mos verifikim i pronave për qëllime të tatimit në pronë

**Gjetja** Sipas nenit 15.2 të ligjit nr. 06/L-005 mbi tatimin në pronën e paluajtshme, aktivitetet inspektuese kryhen çdo vit në së paku 20% të të gjitha objekteve brenda territorit të komunës.

Komuna në vitin 2022, nga 1.493 objekte të regjistruara, nuk ka arritur të kryejë as edhe një inspektim të pasurive të paluajtshme siç parashikon ligji për tatimin mbi pronën e paluajtshme.

Kjo ka ndodhur pasi në njësinë e tatimit mbi pronë është i punësuar vetëm një punonjës i cili për shkak të vëllimit të punës nuk ishte në gjendje të përmbushte këtë kërkesë ligjore.

**Ndikimi** Moskryerja e një kontrolli inspektues pronës së paluajtshme mund të rezultojë në informacione jo të plota mbi gjendjen aktuale të pronës, potencialisht më pak të ardhura të mbledhura në dobi të komunës dhe gjithashtu mund të ndikojë në ngarkesën joadekuate tatimore.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të shqyrtojë plotësimin e vendeve të punës në këtë departament dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e kontrolleve në objekte, në përputhje me dispozitat ligjore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B2 - Mos regjistrimi i pasurisë nën 1000€ përmes sistemit e-pasuria

**Gjetja** Neni 6 pika 3 e Rregullores së MF - nr. 02/2013 - mbi Menaxhimin e Pasurive Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, përcakton se "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Komuna nuk e përdor programin e-pasuria për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë që kanë vlerë nën 1000€, për regjistrimin e këtyre pasurive Komuna përdor aplikacionin Excel, nga i cili nuk ka siguri mbi bazën e të dhënave të ofruara. Totali i pasurisë nën 1,000€ arrin në 92,573€.

Zyrtarët komunal pohojnë se ka probleme teknike me funksionalizimin e këtij softueri.

**Ndikimi** Mospërdorimi i softuerit e-pasuria për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë nën 1,000€ reflekton dobësi në menaxhimin e pasurisë dhe, rrjedhimisht, mund të ndikojë në paraqitjen e gabuar të vlerës së pasurisë në PVF.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të marrë masa për të vendosur funksionimin dhe regjistrimin e e-pasurisë nën 1,000€ në mënyrë që të regjistrohen në sistem të gjitha pasuritë jokapitale në pronësi të komunës.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Të arkëtueshmet

Në raportin vjetor financiar (FSHF) për vitin 2022, komuna ka paraqitur kërkesa në vlerë prej 552,011€. Kjo vlerë përbëhet nga taksat mbi pronën dhe tokën, taksat për kryerjen e veprimtarisë afariste, shitjet e shërbimeve dhe shfrytëzimin e sipërfaqeve publike. Në testin substancial, ne testuam 38 mostra me vlerë 8,760 € dhe 5 mostra në testin e përputhshmërisë.

#### Çështja B3 - Angazhim i pamjaftueshëm për grumbullimin e të hyrave

##### Gjetja

Sipas nenit 26 të ligjit nr. 06/L-005 mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente ekzekutive kanë kompetencat dhe përgjegjësitë që u janë dhënë nga ky kapitull për mbledhjen e detyrimeve tatimore të prapambetura që kalojnë shumën prej dhjetë (10) euro, dhe neni 27. Nëse tatimpaguesi ose debitori nuk e ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën, nëse i është shqiptuar, ose detyrimet e prapambetura tatimore, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna lëshon njoftimin e fundit me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga skadimi i ditës së fundit për pagesën e borxhit, i cili kërkon pagesën e shumës totale të detyrimeve të prapambetura jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike nga përfundimi i ditës kur supozohet se debitori ka mundur të marrë njoftimin e fundit.

Në raportin vjetor financiar (RVF) për vitin 2022, komuna ka paraqitur Llogari të Arkëtueshme (LI.A) në vlerë prej 546,832€. Kjo vlerë përbëhet nga taksat mbi pronën dhe tokën, taksat për kryerjen e veprimtarisë afariste, shitjet e shërbimeve dhe shfrytëzimin e sipërfaqeve publike.

Komuna nuk ka një plan dhe nuk ka zbatuar një mekanizëm të përcaktuar me ligj për shlyerjen e kërkesave ndaj debitorëve të saj. Si rezultat i kësaj, të arkëtueshmet janë vazhdimisht në rritje, gjë që shkakton vështirësi në arkëtimin e tyre. Në vitin 2022 ka një rritje të arkëtueshme prej 53,314€ ose 11% krahasuar me vitin paraprak. Rritje të konsiderueshme në të arkëtueshmet e përgjithshme këtë vit kanë pasur: të arkëtueshmet nga tatimi në pronë, të cilat në vitin 2022 janë rritur për 35,531€, të arkëtueshmet nga shitja e shërbimeve (grumbullimi i mbeturinave) ka një rritje prej 17,038€, të arkëtueshmet nga kryerja e aktiviteteve afariste janë rritur për 5,697€, ndërsa LI.A. nga shfrytëzimi i hapsirave publike janë zvuqruar për 4,952€.

Rritja e LI.A ka ndodhur për shkak se Komuna nuk ka ndërmarrë hapa konkretë ligjorë apo paralajmërues për të inkurajuar tatimpaguesit të shlyejnë borxhet e tyre. Njëkohësisht, kjo situatë tregon edhe për mosfunksionimin e duhur të njësive përkatëse për menaxhimin e duhur të të ardhurave dhe llogarive të arkëtueshme.

Kjo ka ndodhur për shkak se Komuna nuk ka ndërmarrë hapa konkretë ligjorë apo paralajmërues për të inkurajuar tatimpaguesit të shlyejnë borxhet e tyre. Njëkohësisht, kjo situatë tregon edhe për mosfunksionimin e duhur të njësive përkatëse për menaxhimin e duhur të të ardhurave dhe llogarive të arkëtueshme.



**Ndikimi** Moszbatimi i mekanizmave të përcaktuara me ligj dhe rregullore ndikon në rritjen e vazhdueshme të kërkesave, gjë që rezulton në më pak fonde për arritjen e qëllimeve dhe inkurajon debitorët e tjerë të mos përmbushin detyrimet e tyre.

**Rekomandimi B3** Kryetari i komunës duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për mbledhjen e të hyrave, si dhe të forcojë kontrollin e brendshëm duke vendosur mekanizma të përshtatshëm për mbledhjen e tyre.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.2 Funkzioni i auditimit të brendshëm

### Çështja C1 - Njësia e Auditimit të Brendshëm jo funksionale në komunë

#### Gjetja

Sipas Rregullores QRK - Nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 4 parashikon se komuna ka katër mënyra për të zbatuar auditimin e brendshëm: krijimin e një njësie auditimi brenda komunës, një njësi të përbashkët me subjektet e tjera të sektorit publik, një marrëveshje me një subjekt publik me ofrimin e shërbimeve të auditimit ose kontraktimin e një kompanie profesionale.

Komuna ka themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB), e cila funksionon me një auditor, i cili është edhe Drejtor i NJAB. Drejtori i NJAB ka përgatitur një plan strategjik trevjeçar, planin vjetor të auditimit për vitin 2022, si dhe raport për gjashtë muajt e parë i cili është miratuar nga menaxhmenti i komunës.

Në vitin 2022, NJAB planifikoi të kryejë pesë auditime bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe përcaktimin e prioritetit. Plani i miratuar nuk është zbatuar plotësisht nga NJAB, as raporti për gjashtëmujorin e dytë dhe as raporti vjetor nuk është përgatitur. Kjo ka ndodhur sepse auditori i brendshëm ka qenë në pushim pa pagesë nga shtatori deri në fund të vitit dhe si rrjedhojë Njësia e auditimit të brendshëm nuk ishte funksionale.

#### Ndikimi

Mosfunksionimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm gjatë vitit nënkupton se Komuna nuk ka siguruar një mekanizëm të pavarur dhe objektiv, i cili shërben si këshilltar në ofrimin e garancive të arsyeshme për efektivitetin e kontrolleve të brendshme në komunë dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të punës.

#### Rekomandimi C1

Kryetari i komunës duhet të sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm të fillojë kryerjen e auditimeve sipas planit të saj.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi dhënë një përmbledhje të informacionit mbi burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve dhe mbledhjen e të hyrave, sipas kategorive ekonomike. Kjo ilustronet përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>1,569,421</b>	<b>1,708,375</b>	<b>1,524,423</b>	<b>1,588,396</b>	<b>1,961,837</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	1,462,650	1,462,650	1,418,927	1,388,493	1,879,797
Financimi përmes huamarrjes	0	18,895	18,139	5,444	16,380
Të bartura nga viti i kaluar	0	117,636	60,156	157,777	55,083
Të hyrat vetanake	106,771	106,771	27,200	36,681	10,576
Donacionet e jashtme	0	2,423	0	0	0

Buxheti final për vitin 2022, krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 138,954€. Diferenca ndërmjet buxhetit fillestar dhe atij final është rezultat i rritjes së transferimit të të hyrave vetanake nga viti paraprak (117,636€), të hyrave nga donacionet e jashtme në vlerë prej (2,423€) dhe financimit nga huamarrja në vlerë prej 18,895€.

Në vitin 2022, komuna ka shpenzuar 89% të buxhetit final, që është në të njëjtin nivel me vitin 2021.

Shpjegimet për gjendjen aktuale janë paraqitur më në detaje më poshtë.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>1,569,421</b>	<b>1,708,375</b>	<b>1,524,423</b>	<b>1,588,396</b>	<b>1,961,837</b>
Pagat dhe mëditjet	1,125,600	1,144,495	1,109,387	1,124,869	1,111,363
Mallrat dhe shërbimet	210,000	231,635	190,971	213,606	217,205
Komunalitë	45,000	65,000	35,425	37,151	39,581
Subvencionet dhe transferet	70,000	91,919	48,062	37,343	295,394
Investimet Kapitale	118,821	175,325	140,578	175,426	298,294

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë buxhetore janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final në kategorinë paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar është më i lartë për 18,895€, është shpenzuar 97%. Kjo rritje është rezultat i financimit nga huamarrja, ndërsa fondet e pashpenzuara ishin nga granti qeveritar në vlerë prej 34,352€ dhe financimi nga huamarrja 756€.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, krahasuar me atë fillestar është rritur për 21,635€, ndërsa janë shpenzuar 82%. Kjo rritje vjen nga të hyrat e bartura nga viti 2021 prej 19,400€ dhe donacionet e jashtme 2,235€. Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2022 realizimi i buxhetit për mallra dhe shërbime është më i ulët për 22,635€ ose 12%. Pjesa më e madhe e shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve përbëhet nga: Shpenzimet tjera kontraktuese 76,767€, Mirëmbajtja dhe riparimi 42,328€, Mobiljet dhe pajisjet tjera 15,518€ dhe regjistrimi i veturave 8,042€.
- Buxheti final për shpenzime komunale është 65,000€, krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 20,000€, janë shpenzuar 35,425€ ose 55%.
- Buxheti final për subvencione, krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 21,919€, janë shpenzuar 52%. Buxheti final për subvencione është rritur për shumën e të hyrave vetanake të bartura nga viti 2021 për 21,919€. Realizimi i buxhetit final krahasuar me vitin paraprak 2021 është më i lartë për 22%. Mjetet e pashpenzuara nga buxheti final janë nga të hyrat vetanake për 42,700€ dhe të hyrat e transferuara në vlerë prej 58€.
- Buxheti final për investime kapitale, krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 56,504€, ndërsa janë shpenzuar 80%. Rritja e buxhetit final krahasuar me atë fillestar është nga të hyrat vetanake të bartura nga viti 2021 për 56,316€ dhe donacioneve të jashtme për 188€. Ndërsa fondet e papërdorura janë nga të hyrat vetanake 31,216€, nga granti qeveritar 1,539€ dhe donacionet e jashtme 188€. Krahasuar me vitin paraprak, realizimi i buxhetit për investime kapitale është më i ulët për 34,848 ose 25%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Për vitin 2022 komuna ka inkasuar të hyra vetanake në vlerë prej 98,241€, këto janë të hyra nga tatimi në pronë, të hyra nga tarifat e aktiviteteve afariste, të hyrat nga shitja e shërbimeve dhe shfrytëzimi i hapësirave publike etj. Në vitin 2022, komuna ka mbledhur 8,753€ më shumë të hyra se në vitin paraprak, 2021.

Komuna gjithashtu ka inkasuar të hyra indirekte nga gjobat në trafik në vlerë prej 3,445€ dhe të hyra nga Agjencia e pyjeve 4,115€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>106,778</b>	<b>106,778</b>	<b>98,241</b>	<b>89,487</b>	<b>60,131</b>
Të hyrat tatimore	40,000	40,000	35,552	31,642	27,837
Të hyrat jo tatimore	66,778	66,778	62,689	57,845	32,294

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për RVF-në e vitit 2021 për Komunën e Ranillugut ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime. Komuna ka përgatitur një Plan Veprimi që tregon se si të zbatohen rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2022, tri (3) rekomandime janë zbatuar, tri (3) rekomandime janë përsëritur dhe një (1) pjesërisht e zbatuar, siç tregohet në grafikun 2 më poshtë. Për një përshkrim më të detajuar të rekomandimeve dhe se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4 (ose Tabelën e Rekomandimeve).

Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Ranillugut për vitin 2021 nuk është shqyrtuar nga Kuvendi Komunal.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta.	Komuna ka marrë masa për ta zgjidhur këtë çështje.	I zbatuar

2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë hartimit të PVF-ve, në mënyrë që PVF-të për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të nënshkruaj vetem pasi që janë siguruar se PVF-të prezantojnë të dhëna të plota dhe të sakta.	Gjatë auditimit, pas identifikimit të gabimeve dhe këshillave tona, komuna ka marrë masa dhe ka bërë korrigjimet e nevojshme dhe versioni i rishikuar i RVF-ve është përgatitur në përputhje me standardet.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të marrë në konsideratë plotësimin e vendeve të punës në këtë departament, dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer verifikimin e objekteve sipas dispozitave ligjore.	Ende nuk ka arritur të bëjë verifikimin sipas dispozitave ligjore.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë funksionalizimin e sistemit E-pasuria siç e kërkon rregullorja në fuqi.	Edhe këtë vit Komuna ka raportuar pasuritë nën 1000 euro nga regjistri i Excel-it.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të analizojë në mënyrë të detajuar gjendjen e borxheve që debitorët i detyrohen komunës, të propozoj masa më efektive si dhe të aplikoj të gjithë mekanizmat në dispozicion për mbledhjen e këtyre borxheve, duke mos përjashtuar edhe masat ligjore.	Edhe në këtë vit kemi rritje të llogarive të arkëtueshme për 53,314€ në raport me vitin e kaluar. Nuk ka veprime për mbledhjen e tyre siç përcaktohet me ligj.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të themelojë dhe ta bëjë funksional komitetin e auditimit, që t'i rishikojë rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.	Komuna ka formuar Komitetin e Auditimit.	I zbatuar

7.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari i Komunës të sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm, të filloj me kryerjen e auditimeve sipas planit të saj	Plani i miratuar nuk është zbatuar plotësisht nga NJAB, as raporti për gjashtëmujorin e dytë dhe as raporti vjetor nuk është përgatitur, sepse auditori i brendshëm ka qenë në pushim pa pagesë nga shtatori deri në fund të vitit dhe si rrjedhojë Njësia e auditimit të brendshëm nuk ishte funksionale.	Pjesërisht i zbatuar
----	----------------------	---	--	----------------------



Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Nebojsa Ristić, Udhëheqës i ekipit



Stana Dancetović, Anëtare e ekipit



Hysen Restelica, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.